



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 217 Prot.
6

Koplik, më 26.12.2024

VENDIM

NR, 72 DATË 26 / 12 / 2024
PËR

1. "Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës, të z. Engjell Gjon Maklaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit. si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit Engjell Gjon Maklaj, burimi financiar do jete nga nga programi Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 3280, në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr 6 datë 18.01.2024 "për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afat mesem 2024-2026 të Bashkisë Malësi e Madhe".

Baza Ligjore

Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar
Ligji për Prefektin e Qarkut
Ligji Nr. 45/2019 Për mbrojtjen civile,
VKM nr.329 datë 16/5/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"
VKM, Nr.965, datë 02/12/2015 „Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave“.

Vendosi;

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për mbështetje financiare të familjes së shtetasit z. Engjell Gjon Maklaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.
2. Burimi i financimit të jetë fondi i Emergjencave Civile parashikuar në Programin "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile", në buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2024 të miratuar me VKB. .06..date 18..01.2024 në programin "Perballimi i ndihmave të menjëhershne për familjet në raste fatkeqesie".
3. T'i akordojë familjes së shtetasit Z. Engjell Gjon Maklaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, dhënien e ndihmës së menjëherëshme/emergjente financiare në vleren/shumen 100.000 (njqind mijë) lekë , në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr.6, datë, 18.01.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 të Bashkisë Malësi e Madhe ", nga fondi i buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe, nga Programi "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 03280".

4. Vlera e e plote e dëmit në paisje orendi është **236.900**(dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind)lekë,50% i saj është **118,450** (Njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë.
5. Ngarkohet administrata e Bashkisë Malësi e Madhe për likuidimin e shumes prej **100.000** (njëqindë mijë) lekë.
6. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Finances dhe sektori i Emergjencave Civile.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 26.12.2024

Vota Pro 20

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 4

Zbardhur me date 26.12.2024

